MBI AUDTIMIN E USHTRUAR NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DURRËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës me objekt: "mbi procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, regjistrimin e pasurive, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve, si dhe zbatimin e procedurave ligjore në aplikimin e tarifave për kalimin e pronësisë" për periudhën 01/01/2009-30/6/2011" dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendim të Kryetarit të KLSH nr. 54, datë 20/4/2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01/6/2000, me shkresën nr. 382/20, datë 20/4/2012 dërguar **z. Bedri LUKU,** regjistrues i ZVRPP Durrës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Për Zyrën Vendore Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës.

1. Nga Regjistruesi të nxirret urdhri i brendshëm për zbatim, që në momentin e kryerjes së inventarizimit të dokumentacionit që ndodhet në referencë, të vendoset detyrimisht numri i çdo dokumenti sipas radhës në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", neni 24, germa "b" dhe të neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për "Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror" dhe "Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore".

Vazhdimisht

2. Nga Regjistruesi të merren masat e mëposhtme:
a. Të mos kryhen veprime në kartela të pasurive të paluajtshme, të panënshkruara nga specialistët përkatës, si dhe të pa nënshkruara dhe pavulosura nga Regjistruesi.
b. Kartelat e pasurive të paluajtshme të nënshkruhen nga punonjësi që kryen veprimet në kartelë, të plotësohet data përfundimtare, të mbyllen kartelat, si dhe të përcaktohet në cilin volum vijojnë pasuritë e ndara.
c. Të mos kryhen më veprime në kartela të kartelat e pasurive të paluajtshme, me urdhër të panënshkruar dhe të pavulosur, nga Regjistruesi.

Vazhdimisht

3. Të merren masa nga Regjistruesi i ZVRPP Durrës, që në bazë të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" i ndryshuar, neni 44, germa "b" e "c", të nxjerrë urdhër kufizimi, si dhe në bazë të ligjit nr. 9948, datë 07.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", neni 1 dhe neni 9, t'i kërkojë komisionit vendor të verifikimit të titujve të pronësisë, verifikimin e disa AMTP, kufizimi të zgjasë deri në kthimin e përgjigjes nga komisioni vendor, sipas të metave të konstatuara dhe trajtuar në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, konkretisht:

Zona kadastrale 1204,

- Për 8 raste me sipërfaqe 10,320 m^2, trajtuar në faqen 2, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit dhe sipas pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur.

Zona kadastrale 3365,

- Për 16 raste me sipërfaqe 15,604 m^2, trajtuar në faqen 2, dhe sipas pasqyrës nr. 2, bashkëlidhur të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Zona kadastrale ZK 3385 Shkallnur,

- Për pasurinë nr. 173/17, volum 11 faqe 29, pasurinë 173/68, vol 16 faqe 178, të kufizohet deri në plotësimin e dokumentit ligjor (AMTP) trajtuar në faqen 2, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.
- Për pasurinë nr. 454/5, volum 9 faqe 149, të kufizohet deri në plotësimin e dokumentit ligjor (AMTP), trajtuar në faqet 3-4, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Zona kadastrale ZK 1522 Draç,

- Për 3 raste me sipërfaqe 1.579 m^2 tokë arë, trajtuar në faqen 2 dhe sipas pasqyrës nr. 3, bashkëlidhur të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Zona kadastrale ZK 2978 Pjezë,

- Për 12 raste me sipërfaqe 8,730 m^2 tokë arë, trajtuar në faqen 2, dhe sipas pasqyrës nr. 4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Zona kadastrale 1204,

- Për AMTP nr. 8 datë 01.11.1994, trajtuar në faqen 2, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Zona kadastrale ZK 3385 Shkallnur.

- Për AMTP nr. 144, datë 08.8.1993 dhe AMTP nr. 213, datë 26.9.1996, trajtuar në faqet 3-4, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

4. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Durrës, që në bazë të ligjit nr. 7843, datë 13. 07.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" i ndryshuar, neni 44, germa "b" dhe "c", të nxjerrë urdhër kufizimi, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në faqet 4-8, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit, deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor dhe konkretisht:

Zona kadastrale 1204 Bizë, ZK 2375 Lalëz,

- Për pasurinë nr. 445/71, volum 6 faqe 122, të kufizohet deri në plotësimin në rrugë administrative ose gjyqësore, të vendimit, si dhe ZVRPP Durrës të vërë në dijeni individin që ti drejtohet AKKP Tiranë për saktësimin e vendimit nr. 155, datë 25.05.2009, të AKKP Durrës, i cili nuk përcakton kufizimet e pronës, nuk është ndarë sipërfaqja pyll me sipërfaqen tokë pa fryt (PF), si dhe nuk është ndarë zona kadastrale, gjithashtu në plan vendosjen bashkëlidhur vendimit në seksionin "B" nuk është ndarë sipërfaqja sipas llojit të pasurisë Pyll, arë, tokë pa fryt dhe kanal.

Zona kadastrale 1522 Draç,

- Për pasurinë nr. 152/2, volum 5 faqe 2, të kufizohet deri në plotësimin e vendimit në rrugë administrative ose gjyqësore, si dhe ZVRPP Durrës të vërë në dijeni individin që ti drejtohet AKKP Tiranë për saktësimin vendimit nr. 157, datë 26.05.2009, të Agjencisë Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Durrës, i cili nuk ka përcaktuar llojin e pasurisë dhe numri e pasurisë, pasi pasuria me nr. 152/2 vjen nga volum 2 faqe 136 lloji ranishte dhe regjistrohet në volum 5 faqe 2 lloji pa fryt (PF).

Zona kadastrale 8516 Durrës,

- Për pasurinë pasuria nr. 10/139-ND, volum 10, faqe 221, deri në plotësimin kontratës së shitjes nr. 741, datë 07.04.2000, lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Privatizimit Tiranë, Uzinës Mekanike të pjesëve të Ndërtimit Durrës (UMNP) dhe subjekti privat, pasi Akt dorëzimi i objektit është hartuar datë 06.03.2000, ndërsa kontrata nr. 741, datë 07.04.2000, pra rezulton se objekti është dorëzuar një muaj para lidhjes së kontratës së shitblerjes, si dhe nuk është shkresa nr. 5122, datë 05.08.1999, të MEPP-së.

Zona kadastrale 8517 Spitallë,

- Për pasurinë nr. 58/267, volum 14 faqe 185, deri në plotësimin nga organet përkatëse në rrugë administrative ose gjyqësore, të vendimit nr. 811, datë 04.04.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve Bashkia Durrës, i cili nuk përcakton kufizimet përkatës, gjithashtu mungon shkresa përcjellëse nga KKKP ish-pronarëve Bashkia Durrës, si dhe procesverbali i dorëzimit të pronës nga KKKP ish-pronarëve.

Zona kadastrale 1574 NB Frutore,

- Për pasurinë nr. 463/76, volum 9 faqe 172, të kufizohet deri në saktësimin e sipërfaqes së pjesës që sipas plan vendosjes që shoqëron vendimin e gjykatës, bie pjesërisht në detin Adriatik.

Ky kufizim të zgjasë deri në momentin e saktësimit të pasurisë, ku të përputhet akt ekspertiza e përgatitur nga topografi me licence me hartën treguese (hartën e punës).

Menjëherë

5. Të merren masa nga Regjistruesi i ZVRPP Durrës, që në bazë të ligjit nr. 7843, datë 13. 07.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" i ndryshuar, neni 44, germa "b" e "c", të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor, nga organet përkatëse në rrugë administrative ose gjyqësore, bazuar në shkeljet e konstatuara, konkretisht:

- Për pasurinë nr. 6/470 , lloji pasurisë truall, vol 52 faqe 91, sipërfaqe 210 m2, ZK 8513,
- Për pasurinë nr. 6/461 , lloji pasurisë truall, vol 52 faqe 82, sipërfaqe 220 m2, ZK 8513,

pasi të dy këto regjistrime janë kryer duke u bazuar në vendimin nr. 364/1 datë 17.03.1994 të KKKP-së të qytetit të Durrësit, i cili në dizpozitivin e tij i ka njohur vetëm të drejtën e pronësisë trashëgimtarëve të ish-pronarit, dhe jo kthimin fizik të kësaj prone.

- Për pasurisë nr. 29/55, lloji trualli, sipërfaqe prej 560 m^2, Vol. 17, faqe 25, ZK 8512, regjistruar sipas vendimit të KKKPP të Qarkut Durrës, nr. 1481/1, datë 18.03.2002, për kompensim fizik, pasi ky regjistrim është kryer pa disponuar skicën përkatëse që shoqëron vendimin për të përcaktuar sipërfaqen që është kompensuar, sipas vendimit për kompensim fizik.

- Për pasurinë nr. 29/128, lloji truall, sipërfaqja 741.5 m^2, vol 44 faqe 228, ZK 8512, e cila është regjistruar bazuar në vendimin nr. 463/5, datë 14.06.2002, të KKKP-së pranë prefekturës Durrës, pasi plan vendosja që shoqëron vendimin e mësipërm të komisionit është e korrigjuar në të gjithë elementët e tij, si sipërfaqja e pasurisë dhe ç'është dhe më e rëndësishme numri dhe data e vendimit të komisionit kthimit pronës.

- Për pasurinë nr. 27/109, lloji truall, me sipërfaqe 400 m^2, vol 17, faqe 225, ZK 8518 dhe pasurinë nr. 27/108, lloji truall, me sipërfaqe 440 m^2, vol 17, faqe 178, ZK 8518**,** pasi regjistrimi i të dy pasurive është bërë bazuar me të njëjtin vendimin nr. 1173/2 datë 28.06.2002, të KKKP, pranë Prefekturës Durrës, për kompensim, një me sipërfaqe trualli 400 m2, dhe tjetra me sipërfaqe 440 m^2, ku kompensimi i këtyre pasurive është bërë në brezin e ranishtës publike buzë detit, dhe në referencën e dytë vendimi i KKKP-së është fotokopje dhe i pa noterizuar.

Menjëherë

6. Të merren masa nga Regjistruesi i ZVRPP Durrës, që në bazë të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" i ndryshuar, neni 44, germa "b" e "c", të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor të miratuar nga organet përkatëse, bazuar në shkeljet e konstatuara, konkretisht:

- Për pasurinë nr. 3/563-ND, lloji pasurisë pallat, sipërfaqja totale 377.5 m^2 dhe ndërtesa 377.5 m^2, Vol. 52, faqe 92, ZK 8513, deri në realizimin e kontratës së shitblerjes për sipërfaqen 23.83 m^2 sipas vendimit të gjykatës, pasi me vendimin nr. 2902 datë 08.11.2010, të gjykatës

është vendosur detyrimi i Bashkisë Durrës të njohë pronar subjektin ndërtues për këtë sipërfaqe toke truall në pronësi të shtetit.

- Për pasurinë nr. 816/2-Nd, lloji ndërtesë, vol 50, faqe 177, ZK 8513, sipërfaqja e truallit 390 m2 dhe sipërfaqja e ndërtimit 276.6 m^2, pasi ky regjistrim është kryer pa disponuar dokumente tekniko ligjor të miratuara nga KRRT-ja, por duke u bazuar në dokumentet tekniko ligjor të cilët kundërshtojnë njëri tjetrin, kur ato duhet të ishin në vijueshmëri dhe të plotësonin njëri tjetrin.

- Për pasurinë nr. 2/909-ND, lloji ndërtesë, vol 53 faqe 102, sipërfaqja 2035 m^2, ZK 8513, pasi ky regjistrim është kryer në kundërshtim me lejen për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij (lejen e sheshit të ndërtimit), lejen e ndërtimit, planimetrinë që shoqëron lejen e sheshit dhe projektit teknik të miratuar nga KRRT-ja, pra pa disponuar dokumente tekniko ligjor të miratuara nga KRRT-ja.

- Për pasurinë nr. 60/24-ND, lloji ndërtesë, vol 72 faqe 148-196, sipërfaqja 320m^2, ZK 8518, pasi ky regjistrim është bërë pa disponuar formularin nr. 2, leja për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij (sheshit të ndërtimit), planimetrinë që shoqëron lejen e sheshit për këtë objekt, si dhe projektin-teknik për objektin "Zgjerimin e papafingos dhe shtesën e papafingos", të cilat duhej të miratoheshin në KRRT-në e njësisë vendore, përpara miratimit të lejes së ndërtimit nr. 6, datë 25.11.2009 me objekt "Zgjerim papafingo + papafingo në godinën ekzistuese 6 kate + 1 kat dyqane + 1 kat nëntokë + papafingo".

Menjëherë

7. Të merren masa nga Regjistruesi i ZVRPP Durrës, që në bazë të ligjit nr. 7843, datë 13. 07.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" i ndryshuar, neni 44, germa "b" e "c", të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur ligjor, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe konkretisht:

- Për pasurinë nr. 2/522, lloji truall, sipërfaqja 9000 m^2, vol. 36 faqe 4, ZK 8513, pasi në referencën përkatëse mungonte kontrata e shit-blerjes midis Bashkisë dhe individit e lidhur para noterit, për arsye se kjo pasuri është regjistruar bazuar në vendim gjykate, e cila ka detyruar Bashkinë Durrës që ti shesë subjektit privat truallin me sipërfaqe prej 9000 m^2.

Menjëherë

8. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Durrës, që në bazë të ligjit nr. 7843, datë 13. 07.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" të ndryshuar, neni 44, germa "b" dhe "c", të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe konkretisht:

- Për pasurinë nr. 22/55, volum 30 faqe 50, ZK 8512**,** deri në plotësimin e dokumentacionit teknik e ligjorë që i bashkëlidhet lejes së shfrytëzimit të objektit, si dhe korrigjimin e KPP-së, sa regjistruar më shumë se vendimi nr. 1936, datë 13.07.2010, të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës.

- Për pasurinë nr. 24/179-ND, volum 46, faqe 13, ZK 8512**,** deri në daljen e urdhrit të Regjistruesit për bashkimin e pasurive, plotësimin e dokumentacionit me leje shesh ndërtimi.

- Për pasurinë nr. 4/255, volum 45, faqe 249, ZK 8512, legalizuar në kundërshtim me pikën 2, germa "c" të VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të proceduarave dhe dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo".

- Për pasurinë nr. 27/249, volum 44, faqe 234, ZK 8512, deri në daljen e urdhrit të Regjistruesit për ndarjen dhe bashkimin e pasurive.

- Për pasurinë nr. 18/286, volum 45, faqe 21, ZK 8512, duke ndarë dhe regjistruar në KPP në pronësi të Shtetit sipërfaqe 14.^{26} m^2.

- Për pasurinë nr. 16/220, volum 46, faqe 68, ZK 8512, deri në plotësimin nga organet përkatëse në rrugë administrative ose gjyqësore, të vendimit nr. 178, datë 26.11.1993, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve Bashkia Durrës, i cili nuk shprehet për kthimin e pronës.

- Për pasurinë nr. 23/283, volum 44, faqe 13, pasurinë nr. 23/287, volum 44, faqe 14, pasurinë nr. 23/284, volum 44, faqe 16, pasurinë nr. 23/159, volum 23, faqe 170, ZK 8512, deri në plotësimin në rrugë administrative ose gjyqësore, të vendimit nr. 187, datë 26.06.2009, të ZRKKP Qarku Durrës, i cili nuk ka përcaktuar llojin e pasurisë dhe kufizimet.

- Për pasurinë nr. 15/5, volum 1, faqe 169, ZK 3369, deri në plotësimin nga organet përkatëse në rrugë administrative ose gjyqësore, të vendimit nr. 35, datë 08.04.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve Bashkia Shijak, i cili nuk shprehet për kthimin e pronës.

- Për pasurinë nr. 15/3, volum 1, faqe 145, ZK 3369, deri në plotësimin nga organet përkatëse në rrugë administrative ose gjyqësore, të vendimit nr. 30, datë 25.02.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve Bashkia Shijak, i cili nuk shprehet për kthimin e pronës, si dhe plotësimin e dokumentacionit ligjor që i bashkëlidhet lejes së shfrytëzimit.

- Për pasurinë nr. 2/7, volum 1 faqe 245, ZK 3369, deri në plotësimin e vendimit nr. 177 datë 05.02.1993, të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës, pasi ky vendim nuk përcakton sipërfaqen e objektit dhe sipërfaqen e oborrit, si dhe plotësimin e dokumentacionit teknik e ligjor, që duhet t'i bashkëlidhet lejes së shfrytëzimit.

- Për pasurinë nr. 19/2-ND, volum 2 faqe 46, ZK 3369, deri në plotësimin e vendimit nr. 1689 datë 16.06.1995, të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës, i cili nuk ka të përcaktuar sipërfaqen e objektit, si dhe plotësimin e dokumentacionit teknik e ligjor që duhet t'i bashkëlidhet lejes së shfrytëzimit.

Menjëherë

9. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Durrës, që në bazë të ligjit nr. 7843, datë 13. 07.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" i ndryshuar, neni 44, germa "b" e "c", të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e vendimeve ish-KKKP-ve, nga organet përkatëse në rrugë administrative ose gjyqësore, bazuar në shkeljet e konstatuara si më poshtë;

- Për pasurinë nr. 9/90, lloji pasurisë truall, e regjistruar në numrin hipotekarë 38, datë 20.04.2010 dhe sipas regjistrimit sporadik në volum 12, faqe 202, me sipërfaqe 2.640 m2, ZK 8518.

- Për pasurinë nr. 47/89, lloji pasurisë truall, e regjistruar në numër hipotekar 108, datë 24.06.2009, dhe sipas regjistrimit sporadik në volum 31, faqe 125, sipërfaqe 400 m2, ZK 8518,

- Për pasurinë nr. 27/173, lloji pasurisë truall, e regjistruar në numër hipotekar 42 datë 04.05.2010 dhe sipas regjistrimit sporadik në volum 65, faqe 209, sipërfaqe 401 m2, vijuar nga regjistri hipotekarë numër 163, datë 07.03.1994, ZK 8518,

- Për pasurinë nr. 52/76, lloji pasurisë truall, e regjistruar në numër hipotekar 25, datë 14.02.2009 dhe sipas regjistrimit sporadik në volum 33 Faqe 221, sipërfaqe 1.000 m2, vijuar nga regjistri hipotekarë 766 datë 04.09.1995, ZK 8518,

- Për pasurinë nr. 38/126, lloji pasurisë truall, e regjistruar në numër hipotekar 75 datë 25.04.2009, dhe sipas regjistrimit sporadik në vol 24, faqe 125, me sipërfaqe prej 179.1 m2, për pasurinë me numër 38/127 me sipërfaqe prej 179.1 m2 e regjistruar në numrin hipotekarë 76,

datë 25.04.2009 dhe sipas regjistrimit sporadik në volum 24, faqe 126, për pasurinë me numër 38/128 me sipërfaqe prej 179.1 m2 e regjistruar në numrin hipotekarë 77, datë 25.04.2009 m2, dhe e regjistruar sipas regjistrimit sporadik në volum 24 faqe 127, ZK 8518,

pasi pasuritë e lartpërmendura, janë regjistrime në regjistrat hipotekarë, si dhe janë kryer transaksione të ndryshme, duke u regjistruar sipas regjistrimit sporadik në volumet përkatëse, duke u bazuar në vendimet ish-KKKP-ve të qytetit të Durrësit, të cilat në dizpozitivin e tyre janë shprehur se ju njihet e drejta e pronësisë trashëgimtarëve të ish pronarit, dhe jo për kthimin në natyrë të pronësisë.

Menjëherë

10. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Durrës, që në bazë të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" i ndryshuar, neni 5, germa "d" dhe neni 44, germa "b" e "c", të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe konkretisht:

- Për pasurinë numër 30/40, lloj i pasurisë truall, e regjistruar në numrin hipotekarë 102 datë 04.06.2009 dhe sipas regjistrimit sporadik në volum 45 faqe 228, me sipërfaqe 285 m2, ZK 8518.

- Për pasurinë numër 30/225, lloj i pasurisë truall, e regjistruar në numrin hipotekarë 03 datë 12.01.2009 dhe sipas regjistrimit sporadik në volum 58 faqe 230, me sipërfaqe 285 m2, ZK 8518.

- Për pasurinë numër 22/38, lloj i pasurisë truall, e regjistruar në numrin hipotekarë 112 datë 09.08.2010 dhe sipas regjistrimit sporadik në volum 10 faqe 183, me sipërfaqe 500 m2, ZK 8518.

- Për pasurinë numër 58/146 – ND e regjistruar në regjistrin hipotekarë 53 datë 20.01.2011 dhe e regjistruar sipas regjistrimit sporadik në volum 68 faqe 225, ZK 8518,

pasi pasuritë e lartpërmendura janë regjistruar me mangësi në dokumentacionin e duhur ligjor.

Menjëherë

II. Për Ministrinë e Drejtësisë.

Mbështetur në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" të ndryshuar, neni 6, neni 8, të ***kërkojmë nga Ministri i Drejtësisë***, vlerësimin e shkeljeje të konstatuara nga noterët publik si më poshtë;

- Për [redacted], me detyrë noter Publik.

Për moszbatim të kërkesave të nenit 3 të ligjit nr. 7890, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve" të ndryshuar, ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore, për kontratën e shitblerjes nr. 424/114 datë 15.01.2003, ndërmjet Këshillit të Qarkut Durrës shitës, dhe subjekti privat blerës.

- Për [redacted], me detyrë noter Publik.

Për moszbatim të kërkesave të nenit 3 të ligjit nr. 7890, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve" të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore, për kontratën e shitblerjes nr. 2635/941 datë 14.07.2003, ndërmjet Bashkisë Shijak shitës, dhe subjekti privat blerës.

- Për [redacted], me detyrë noter Publik.

Për moszbatim të kërkesave të nenit 3 të ligjit nr. 7890, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve" të ndryshuar, ligjit nr. 7829 datë 1.6.1994 "Për Noterinë" të ndryshuar, si dhe

dispozitave të tjera ligjore, për kontratën e shitblerjes nr. 6416/2686 datë 22.12.2004, ndërmjet Bashkisë Shijak shitës, dhe subjekti privat blerës.

III. Për Avokaturën e Shtetit.

- Mbështetur në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", neni 5 , germa "e", dhe Udhëzimit nr. 1 datë 31.01.2007 "Për procedurat e regjistrimit në ZVRPP-të" të Këshillit të Ministrave, pika 1, pika 2/b dhe pika 5/ç dhe 5/d, të njoftohet Avokatura e Shtetit, për mangësitë konstatuara në regjistrimin e pasurive të mëposhtme;

- Për pasurinë nr. 3/563-ND, lloji pasurisë pallat, sipërfaqja totale 377.5 m^2 dhe ndërtesa 377.5 m^2, Vol. 52, faqe 92, ZK 8513, pasi nga verifikimi i sipërfaqeve të trojeve private të cilët sipas kontratës së sipërmarrjes ja kanë dhënë për ndërtim subjektit privat ndërtues, rezulton se është 496 m^2, ndërsa sipërfaqja e sheshit të ndërtimit të miratuar nga KRRT-ja është 519.83 m^2, pra 23.83 m^2 më shumë e cila është e regjistruar në pronësi të shtetit, pra leja e sheshit të ndërtimit është dhënë në kundërshtim me ligjin për urbanistikën dhe aktet nënligjore. Dhe vendimi nr. 2902 datë 08.11.2010, i gjykatës ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e Bashkisë Durrës të njohë paditësin pronar mbi një sipërfaqe toke truall prej 23.83 m^2, duhej të refuzohej të regjistrohej, për arsye se në gjykim nuk ka marrë pjesë pala ndërgjyqësore, e cila figuron e regjistruar në regjistrat e ZVRPP-së pronare e pasurisë, mbi të cilën gjykata ka disponuar me vendim dhe në këtë rast pasuria figuron pronë shtetërore, dhe në gjykim nuk ka marrë pjesë avokatura e shtetit.

- Për pasurinë nr. 2/289, lloji truall, sipërfaqja 390 m2, vol 50, faqe 177, ZK 8513, pasuri kjo e korrigjuar nga sipërfaqja 225 m^2 në sipërfaqen 390 m^2, bazuar në vendimin e gjykatës, pasi në procesin gjygjësor nuk ka qenë palë ndërgjyqësore pronari i regjistruar në regjistrat e ZVRPP-së, si pronarë i pasurisë mbi të cilën gjykata ka disponuar me vendim, si dhe nuk ka marrë pjesë në gjykim avokatura e shtetit. mungon dhe plan vendosja e kësaj pasurie, që shoqëron vendimin e gjykatës.

- Për pasurinë nr. 2/211, lloji truall, vol. 16, faqe 136, me sipërfaqe 53 m^2, dhe pasurinë nr. 2/212, lloji truall, vol. 16, faqe 135, me sipërfaqe 83 m^2, ZK 8514**,** pasi vendimi i gjykatës detyron Entin e Banesave Durrës dhe seksionin e financës të qarkut Durrës të shesë këto dy pasuri me sipërfaqe prej 136 m^2, pa qenë kjo pronë në pronësi të tyre, por në pronësi të shtetit, kontrata e shitjes nuk është lidhur para noterit, si dhe në procesin gjyqësor nuk ka qenë palë ndërgjyqësore pronari i pasurisë i regjistruar në regjistrat e ZVRPP-së si pronare e pasurisë mbi të cilën gjykata e disponon me vendim, si dhe nuk ka marrë pjesë në gjykim avokatura e shtetit.

- Për pasurinë nr. 5/22, lloji truall, sipërfaqja 554 m^2 (vetëm për sipërfaqen 154 m2) vol. 17, faqe 150, ZK 8512, pasi kjo pasuri është korrigjuar nga sipërfaqja 400 m^2, në sipërfaqe 554 m^2, bazuar në vendimin e gjykatës. Në këtë proces gjygjësor nuk ka qenë palë ndërgjyqësore pronari i pasurisë i regjistruar në regjistrat e ZVRPP-së, mbi të cilën gjykata ka disponuar me vendim, si dhe nuk ka marrë pjesë në gjykim avokatura e shtetit.

- Për pasurinë nr. 2/522, lloji truall , sipërfaqja 9000 m^2, vol. 36 faqe 4, ZK 8513, pasi kjo pasuri është regjistruar bazuar në vendim gjykate, e cila ka detyruar Bashkinë Durrës që ti shesë subjektit privat truallin me sipërfaqe prej 9000 m^2 (megjithëse në referencën përkatëse nuk ndodhej ndonjë kontratë shitjeje midis Bashkisë dhe subjektit privat), si dhe në këtë proces gjygjësor nuk ka qenë palë ndërgjyqësore pronari i pasurisë i regjistruar në regjistrat e ZVRPP-së, mbi të cilën gjykata ka disponuar me vendim, për rastin konkret pronar është shteti dhe në gjykim nuk ka marrë pjesë avokatura e shtetit.

B. MASA DISIPLINORE

I- Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, nenet 37, 141, 153, ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, neni 4, dhe në kontratën individuale të punës, ***kërkojmë nga Ministri i Drejtësisë***, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore;

Vërejtje me paralajmërim për "Zgjidhje të kontratës individuale",

- Për [redacted] , me detyrë Regjistrues i ZVRPP-së Durrës.

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar dhe të Rregullores për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në regjistrimin fillestar dhe veprimeve të tjera të pasurive të paluajtshme.

II. Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, nenet 37, 141, 153, dhe në kontratën individuale të punës, ***kërkojmë nga ZQRPP-ja Tiranë***, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

1. "Zgjidhje të menjëhershme të kontratës individuale", për**;**

- **zj. [redacted],** me detyrë juriste.
- **z. [redacted]**, me detyrë inxhinier (hartograf).
- **zj.[redacted]** me detyrë juriste.
- **z. [redacted],** me detyrë inxhinier (hartograf).
- **zj. [redacted],** me detyrë juriste.
- **zj[redacted]** me detyrë inxhiniere (hartograf).
- **z. [redacted] ,** me detyrë jurist.
- **z[redacted].,** me detyrë jurist.

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar dhe të Rregullores për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në regjistrimin fillestar dhe veprimeve të tjera të pasurive të paluajtshme.

2. Vërejte me paralajmërim për "Zgjidhje e kontratës individuale", për;

- **z. [redacted]** me detyrë zv-Regjistrues.
- **zj.[redacted] ,** me detyrë juriste.
- **z. .[redacted],** me detyrë hartograf.
- **z. [redacted],** me detyrë jurist.
- **z. [redacted],** me detyrë hartograf.

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar dhe të Rregullores për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në regjistrimin fillestar e veprimeve të tjera, të pasurive të paluajtshme.

Shënim: Për punonjësit e tjerë, që janë ngarkuar me përgjegjësi në Raport Përfundimtar, nuk kemi propozuar masë disiplinore pasi shkeljet nuk janë kryer në mënyrë të përsëritur dhe nuk kanë krijuar pasoja në mirë funksionimin e institucionit.

Ndërsa, për z. [redacted] me detyre ish-regjistrues, z. [redacted] me detyrë ish-jurist, zj. [redacted], me detyrë ish-juriste dhe z. [redacted] me detyrë ish-jurist, zj. [redacted] me detyrë ish-hartograf, z. [redacted], me detyrë ish-jurist, z. [redacted] me detyrë ish-jurist, nuk rekomandohen masa disiplinore për shkak se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, dhe masat ndaj tyre konsiderohen të ezauruara.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Xhevdet Haxhiu, Qemal Shehu, Dorino Meço dhe Erion Petanaj. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj dhe Drejtori Juridik dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT